

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"AGRO FARM LEKA" SHPK

Sot me daten 27/09/2023 (dymijë e njëzet e tre), ne ortaket themelues :

- **1 Z. EQEREM LEKA**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 07 Shtator 2000, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Letërnjoftimit (kartë identiteti) me Nr. K01107057D.
- **2 Z. ARMAND LEKA**, shtetas Shqiptar , i datëlindjes 28 Korrik 1984, lindur në Elbasan, dhe banues në Durrës, disponues i letërnjoftimit (kartë identiteti), me Nr. I40728078K.
- **3 Z. GEZIM LEKA**, shtetas Shqiptar , i datëlindjes 18 janar 1984, lindur në Lezhë, dhe banues në Durrës, disponues i letërnjoftimit (kartë identiteti), me Nr. I40118064S.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar " AGRO FARM LEKA" SHPK.*

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " AGRO FARM LEKA" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në ,Durrës, Lagjja 11, Rruga Aleksander Goga, Zona Kadastrale 8514, Godina me Nr.Pasurie 1/279, kati i dyte.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Import, eksport, mbjellje të produkteve bujqësore.

Ushtrimin e të gjitha aktiviteteve që synojnë kultivimin e tokës, pylltarinë, mbarështimin e bagëtive, çdo aktivitet tjetër të lidhur me prodhimin, përpunimin, trajtimin, konservimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore, dhe çdo aktivitet tjetër të lidhur dhe të ngjashëm me bujqësinë. Ushtrimi i aktiviteteve në agroturizëm. Tregtia me shumicë dhe pakicë e frutave dhe perimeve dhe produkteve ushqimore në përgjithësi, prodhimin dhe tregtimin e produkteve tipike ushqimore, përpunimi, prodhimi, paketimi, shitja dhe shpërndarja e produkteve ushqimore në përgjithësi, tregtia me pakicë e lëndëve

ushqyese dhe prodhimin e lëndëve të para ushqimore për tu shitur me pakicë, tregtia me pakicë dhe shumicë e lëndëve ushqimore. Tregtia me pakicë dhe shumicë e bimëve dhe luleve, farave, plehrave, vazove, artikuj dhe pajisje të kopshtarisë, artikujve dhe pajisjeve për bujqësi dhe blegtori dhe çdo gjë tjetër që lejon legjislacioni shqiptar.

Rritje gjedhesh dhe shpendesh, mbareshtim bagetish, tregtim në tregun vendas të mishit, qumeshtit dhe nenprodukteve të tyre, import-eksport. Tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve bujqësor, ushqimor, blegtoral, industrial të të gjitha llojeve, import eksport i tyre. Ngritja, hapja dhe administrimi i marketeve, supermarketeve, hipermarketeve brenda dhe jashtë Shqipërisë. Stokimi, magazimi dhe perpunimi i produkteve bujqësor, ushqimor, blegtoral, industrial të të gjitha llojeve.

NENI 4

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë "AGRO FARM LEKA" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 3 kuota, me vlerë nominale 49,000 (dyzet e nëntë mijë), 49,000 (dyzet e nëntë mijë) dhe 2,000 (dy mijë).

Kontributi i ortakëve është i ndare si vijon:

1. EQEREM LEKA zotëron 1 kuotë baraz me 49 % të kapitalit.

2. ARMAND LEKA, zotëron 1 kuotë baraz me 49 % të kapitalit.

3. GEZIM LEKA, zotëron 1 kuotë baraz me 2 % të kapitalit

NENI 5

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrator i shoqërisë do të jetë

- 1- Z. Armand Leka, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shpresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8
NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahej përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9
LIKUJDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10
MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË
" AGRO FARM LEKA" SH.P.K

EQEREM LEKA

ARMAND LEKA

GEZIM LEKA

Egerem Leka

Armand Leka

Gezim Leka

